



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. ___ Prot

Tiranë, më .09.2017

Njoftim

Në zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 8 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brëndshëm të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin Nr. 141, datë 24.12.2008 dhe nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96 datë.17.06.2016, njoftojme se ditën e **Enjte**, **date. 28 .09.2017, ora 10 :00** zhvillohet mbledhja e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

1. Mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes ndërmjet “KESH” sh.a dhe “OST” sh.a, lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s Nr. 194, datë 30.12.2016 (Drejtorite Teknike)
2. Miratimi i Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë së propozuar nga OST sh.a.
3. Në lidhje me fillimin e procedurës për liçensimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike (Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit).
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Diteko sh.p.k për barrësim të aseteve të kompanisë (pajisjet elektromekanike) në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. (Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit).
5. Mbi licencimin e shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “mesmal 1” me fuqi të instaluar 410 kw; “Mesmal 2” me fuqi të instaluar 1 473 kw; “Mesmal 3” me fuqi të instaluar 235 kw; “Selca 2” me fuqi të instaluar 2 388 kw dhe me fuqi totale të instaluar 4 506 kw(Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit).
6. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të saj pranë “Raffaisen Bank” sh.a. (Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit)
7. Në lidhje me fillimin e procedurave për hartimin dhe miratimin e licencës së shpërndarjes së energjise elektrike (Drejtoritë Teknike)

8. Fillimi i procedurës për miratimin e Licenses së Transmetimit Gazit Natyror (Drejtoritë Teknine)
9. Miratimin e Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Jug-Lindore (SEE CAO) (Drejtoritë Teknike)
10. Mbi shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror (Drejtorite Teknike)

KRYETARI

Petrit Ahmeti